



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:016945

Datë: 18.06.2018

Numri i dokumentit: 00063689

PKR.NR.47/2018

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsën Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve B. S., F. H., G. Sh. dhe Sh. S., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me menin 31 të Kodit Penal, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/I.nr.55/18 të datës 12.06.2018, në seancën e shqyrtimit fillestarë pas shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP/I.nr.55/18 të datës 12.06.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av.M. Q., Av. B. A., Av.V. O. dhe av.B. K., me datë 14.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**1.B. S.** nga i ati L. dhe e ëma A., e lindur S., i lindur me datë data e lindjes... në M., Komuna e Kamenicës, ku edhe jeton, student, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**2.F. H.** nga i ati R., e ëma H., e lindur A., i lindur me datë data e lindjes... në fshatin M., Komuna e Gjilanit, ku edhe tani jeton, student i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**3. G. SH.**, na i ati Z., e ëma F., e lindur I., i lindur me datë data e lindjes..., në fshatinë C. Komuna e Gjilanit, ku edhe jeton, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**4.SH. S.**, nga i ati I. e ëma G., i lindur Sh., i lindur me datë data e lindjes... në fshatin M. Komuna e Gjilanit, ku edhe jeton, i pamartuar, punëtor ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTOR

Se me datë 15.05.2018 reth orës 00:25 minuta në Pikën kufitare të Vërmicës se të akuzuarit pa autorizim transportojnë me qëllim të shitjes apo të shpërndarjes substanca psikotrope të llojit marihuanë të cilët me ligj janë të shpallur si narkotik, në atë mënyrë që pas ndalimit në pikën kufitare të Vërmicës në hyrjen nga Shqipëria për në Kosovë të automjetit të cilin e kanë marr me rent të markës “Golf 5” me targa *numri i targës...* ngjyrë e zezë, i cili drejtohej nga i akuzuari B. S. të shoqëruar nga të akuzuarit F. H., Sh. S. dhe granit Sh., pas kontrollimit të detajuar në ulësen e prapme të automjetit është gjetur bimë psikotropike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 5 kg. e 284,5 gr. Të mbështjellur me foli në pesë paketime të vendosura në dy çanta e vërtetuar si pronë e të akuzuarve.

-Këso dore kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me menin 31 të Kodit Penal.

Andaj gjykata në bazë të dispozitivit të lartshënuar 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 dhe nenit 273 paragr.2 lidhur me nenin 31 të KP-së të akuzuarit i:

## GJYKON

1.Të akuzuarin **B. S.**, me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro dhe,

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej euro 5000 (pesëmijë) eurove.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

## DËNIMI UNIK

Me gjobë në lartësi prej 6.000 (gjashtëmijë) euro në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.05.2018 deri më datën 14.06.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

2.Të akuzuarin **F. H.**, me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro dhe,

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej euro 5000 (pesëmijë) eurove.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

### **DËNIMI UNIK**

Me gjobë në lartësi prej 6.000 (gjashtëmijë) euro në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.05.2018 deri më datën 14.06.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

3.Të akuzuarin **G. Sh.**, me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro dhe,

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej euro 5000 (pesëmijë) eurove.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

### **DËNIMI UNIK**

Me gjobë në lartësi prej 6.000 (gjashtëmijë) euro në të cilin dëni do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.05.2018 deri më datën 14.06.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim.

4.Të akuzuarin **Sh. S.**, me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro dhe,

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Në pajtim me dispozitat e nenit 47 të KP me pëlqimin e të akuzuarit.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej euro 5000 (pesëmijë) eurove.

Në kuptim të nenit 80 të akuzuarit i shqiptohet

### **DËNIMI UNIK**

Me gjobë në lartësi prej 6.000 (gjashtëmijë) euro në të cilin dëni do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.05.2018 deri më datën 14.06.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet 20 euro, ndërsa pjesën tjetër të gjobës i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim..

Në kuptim të nenit 275 paragrafi 3 konfiskohet substanca psikotrope të llojit marihuan në peshë të përgjithshme prej 5 kg e 284,5 gram.

Obligohen të akuzuari që të paguajnë shpenzimet e procedurës në lartësi secili prej nga 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, krejt këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën– Prizren PP/I.nr.55/18 të datës 12.06.2018 – kundër të B. S., F. H., G. Sh. dhe Sh. S., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me menin 31 të Kodit Penal, si dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë Prizren – PP/I nr.12/2018 të datës 09.02.2018.

Prokurori i shtetit gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka ngelur në tërësi pranë marrëveshjes së arritur, duke shtuar se pas ngritjes së aktakuzës ndaj të akuzuarve B. S., F. H., G. Sh. dhe Sh. S. për veprën penale si bashkëkryerës, blerja, posedimi dhe shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPP ka lidhur marrëveshje për pranim të fajësisë me kërkesë të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, me ç’ rast prokuroria e shtetit është pajtuar pas negocimit ashtu që ka ardh deri te marrëveshja e pranimit të fajësisë, të akuzuarit kanë lidhur marrëveshje pa kurrfarë presioni, kërcënimi, dhe në prezencë të mbrojtësve të tyre, janë njoftuar për pasojat e pranimit të fajësisë dhe është bërë me dije rekomandimi i dënimit si në marrëveshje. favoret e marrëveshjes kanë qenë të dyanshme, në anën e prokurorisë ka qenë ekonomizimi i procedurës, pasi kishin mu mbajt disa seanca, kërkojmë që të aprovohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë si dhe të shqiptohet denimi i paraparë si në marrëveshje

Mbrojtësi i të akuzuarit B. S. Av.M. Q. ka deklaruar se i mbrojturi i tij qysh në fazën hetimore ka pranuar veprimet me të cilat është ngarkuar i njejt ka shpreh gadishmëri dhe vullnet të plotë që të hyj në negociim për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, unë si mbrojtës jam konsultuar me të akuzuarin, i kam sqaruar të gjitha rrethanat të cilat i parasheh Instituti për marrëveshjen dhe se favoret që ka ky institut, mirëpo kam sqaruar edhe faktin se pranimi i fajësisë nuk do ta liron nga aktakuza, i njejt në prezencën time ka nënshkruar marrëveshjen dhe ka pranuar kushtet si në marrëveshje. Ka propozuar gjykatës që marrëveshjen të aprovojë.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. H. Av. B. A. gjatë seancës ka deklaruar se pasi kjo marrëveshje është arritur me vullnet të lirë në mes të palëve dhe pa presion, si mbrojtës duke ditur favoret e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kjo marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit G. Sh. Av. V. O. ka deklaruar se marrëveshja e nënshkruar në mes të prokurorisë së shtetit, të akuzuarve dhe mbrojtësve është e bazuar në ligj, nënshkruar pa ndonjë presion për shkelje ligjore që mund ketë, ndërsa po ashtu edhe i akuzuari Sh. S. është informuar lidhur me pasojat ligjore të pranimit të fajësisë dhe marrëveshjes së nënshkruar dhe i propozojnë gjykatës që marrëveshjen si të tillë së bashku me dënimin e rekomanduar të aprovojë si të bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. S. Av. B. K. në tërësi e ka mbështetur fjalët e kolegëve dhe ka propozuar gjykatës që marrëveshjen të aprovojë në tërësi si të bazuar.

Të akuzuarit B. S., F. H., G. Sh. dhe Sh. S., në tërësi janë pajtuar me fjalët të dhënë nga mbrojtësit e tyre.

Gjykata nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kështu që gjykata në tërësi ka vërtetuar se me datë 15.05.2018 reth orës 00:25 minuta në Pikën kufitare të Vërmicës se të akuzuarit pa autorizim transportojnë me qëllim të shitjes apo të shpërndarjes substanca psikotrope të llojit marihuanë të cilët me ligj janë të shpallur si narkotik, në atë mënyrë që pas ndalimit në pikën kufitare të Vërmicës në hyrjen nga Shqipëria për në Kosovë të automjetit të cilin e kanë marr me rent të markës “Golf 5” me targa *numri i targës...* ngjyrë e zezë, i cili drejtohej nga i akuzuari B. S. të shoqëruar nga të akuzuarit F. H., Sh. S. dhe granit Sh., pas kontrollimit të detajuar në ulësen e prapme të automjetit është gjetur bimë psikotropike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 5 kg. e 284,5 gr. Të mbështjellur me foli në pesë paketime të vendosura në dy çanta e vërtetuar si pronë e të akuzuarve.

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarve lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre gjykata ka konstatuar se të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar ta pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga të akuzuarit dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës, prandaj edhe ka vendosur që ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve, sidomos moshën e re e të akuzuarve dhe faktin se është hera e parë që të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin, se në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se me këtë dënim të akuzuarit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre, e gjithashtu do të parandalohen edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
Pkr.nr. 47/2018 me datë 14.06.2018

Procesmbajtësja  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues  
Skender Çoçaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Pasi që palët pas shpalljes së aktgjykimit kanë deklaruar se hekin dorë nga ankesa për bazat ligjore për të cilat kanë të drejtë, atëherë ky aktgjykim është i plotfuqishëm me ditën e shpalljes me datë 14.06.2018